



Prishtinë, 24 shtator 2018
Kodi i ZRRE-së: V_1031_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, neni 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 16 paragrafin 4 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Vendimin për lëshimin e Autorizimit Final V_838_2016 të datës 3 tetor 2016 për shoqërinë "SOLAR GREEN ENERGY" SH.P.K. për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese nga panele solare/fotovoltaike, në vendin e quajtur Xharimes ZK Novoselë kapaciteti i instaluar prej 3 MW, komuna e Kamenicës;
- Kërkesën për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit për Autorizimin Final V_838_2016 të datës 3 tetor 2016 edhe për një (1) vit, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panele solare/fotovoltaike, në vendin e quajtur Xharimes ZK Novoselë kapaciteti i instaluar prej 3 MW, komuna e Kamenicës, të datës 02.08.2018 nr. prot. 355/18 të shoqërisë "SOLAR GREEN ENERGY" SH.P.K. me adresë: rr. "Luan Haradinaj" nr. 21/1 Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës, dhe

në seancën e mbajtur me datë 24 shtator 2018 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa e shoqërisë "SOLAR GREEN ENERGY" SH.P.K., dhe **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Autorizimit FINAL V_838_2016 të datës 3 tetor 2016 për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panele solare/fotovoltaike, në vendin e quajtur Xharimes ZK Novoselë kapaciteti i instaluar prej **3 MW**, komuna e Kamenicës, edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me **3 tetor 2019** për ndërtimin e parkut solar fotovoltaik, sipas Lejes së Ndërtimit 06 nr. 25719/16 datë 10.08.2016, të vazhduar me Vendimin 06 nr. 35/2018 të datës 15.03.2018 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, Komuna e Kamenicës.

A r s y e t i m

- o ZRRE me datë 25.09.2013 nga shoqëria "SOLAR GREEN ENERGY" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panele solare/fotovoltaike, në vendin e quajtur Xharimes ZK Novoselë kapaciteti i instaluar prej 3 MW, komuna e Kamenicës, Republika e Kosovës.



- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji pas analizimit të dëshmimeve të prezantuara nga shoqëria “SOLAR GREEN ENERGY” SH.P.K., në seancën e mbajtur me datë 20 shkurt 2015 ka vendosur se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga panelet solare/fotovoltaike, dhe ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar nr. V_703_2015.
- Vendim mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit për Ndërtim, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- ZRRE me datë 18.01.2016 ka pranuar nga shoqëria “SOLAR GREEN ENERGY” SH.P.K., kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së vendimit mbi njoftimin për Autorizimin Preliminar V-703-2015 të datës 20 shkurt 2015, edhe për një afat shtesë ligjor, për të kompletuar aplikacionin për marrjen e Autorizimit Final.
- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në seancën e mbajtur me datë 23 shkurt 2016 ka vlerësuar kërkesën e aplikuesit dhe ka lëshuar vendimin nr. V_791_2016 për shtyrjen e vlefshmërisë së afatit të vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_703_2015 të datës 20 shkurt 2015, edhe për 6 (gjashtë) muaj, gjegjësisht deri me **20 gusht 2016**.
- ZRRE me datë 11.08.2016 nga shoqëria “SOLAR GREEN ENERGY” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim FINAL për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, në vendin e quajtur Xharimes ZK Novoselë kapaciteti i instaluar prej 3 MW, komuna e Kamenicës, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, Lejen Ndërtimore të lëshuar nga Komuna e Kamenicës dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, në mbledhjen e mbajtur me datë 3 tetor 2016, pas vlerësimit dhe analizimit të kërkesave sipas aplikacionit dhe lejeve të lëshuara nga institucionet relevante, ka vendosur që shoqërisë “SOLAR GREEN ENERGY” SH.P.K., ti lëshohet Vendimi për Autorizimin FINAL V_838_2016, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, në vendin e quajtur Xharimes ZK Novoselë kapaciteti i instaluar prej 3 MW, komuna e Kamenicës sipas Lejes së Ndërtimit 06 nr. 25719/16 datë 10.08.2016, të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, Komuna e Kamenicës.
- ZRRE me datë, 02.08.2018 nga shoqëria “SOLAR GREEN ENERGY” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së Vendimit për Autorizimin FINAL V_838_2016 të datës 3 tetor 2016, për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga panelet solare/fotovoltaike, në vendin e quajtur Xharimes me kapacitet të instaluar prej 3 MW, **edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me 3 tetor 2019 për finalizimin e projektit solar/fotovoltaik.**



- Shoqëria "SOLAR GREEN ENERGY"SH.P.K., në kërkesën e saj ka theksuar se: që nga data e pranimit të vendimit për Autorizim final të Bordit të ZRRE-së, kanë filluar përgatitjet e prokurimit të punëve në teren sipas planit dinamik të punimeve, gjithashtu kanë bërë përgatitjet për planifikim të kyçje në rrejt sipas kushteve teknike të dhëna me Pëlqimin Energjetik të lëshuar nga KEDS.
- Shoqëria "SOLAR GREEN ENERGY"SH.P.K., në kërkesën e saj po ashtu ka sqaruar se tashmë i ka porositur dhe blerë panelet solare s'bashku me pjesët përcjellëse nga kompania prodhuese, dhe poashtu janë kontraktuar edhe kompanitë vendore të cilat do të bëjnë vendosjen dhe implementimit e tërësishëm të projektit sipas standardeve Europiane.
- Shoqëria "SOLAR GREEN ENERGY"SH.P.K., në kërkesën e saj ka sqaruar se edhe përkundër vështirësive gjatë kësaj kohe, ka bërë një progres të dukshëm në realizimin e punimeve në ndërtimin e parkut solar fotovoltaik, ku tani më janë kryer punën fizike në teren, janë hapur rruga, kanalet për vendosjen e kabllove, janë siguruar prodhimi i moduleve, konvertorëve, kabllove dhe transformatorëve. Vonesat fillimisht janë shkaktuar nga ana e partnerëve tonë të më parshëm të cilët na kanë shkaktuar probleme, pasi që problemi kryesor ka qenë sigurimi i mjeteve financiare nga Bankat të cilat përmes procedurave administrative dhe të tejzgjatura, kanë vonuar në porositjen e moduleve solare dhe pajisjeve përcjellëse, mirëpo pas arritjes të nënshkrimit të kontratës me kompaninë prodhuese dhe instaluese vendore, është bërë puna më lehtë që të sigurohet edhe financimi nga bankat vendore, dhe si pasojë e këtyre vonesave që kanë dal gjatë implementimit të projektit na kanë sjellë deri te mos-mundësia e përfundimit të projektit brenda këtij afati të planifikuar.
- Shoqëria "SOLAR GREEN ENERGY"SH.P.K., ka sqaruar gjithashtu se, arsyeja e parashtrimit të kërkesës për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final, për ndërtimin e centralit solar fotovoltaik është se, edhe përkundër përpjekjeve të vazhdueshme për të përfunduar realizimin e këtij projekti me interes të veçantë, projekti i cili është i autorizuar nga Bordi i ZRRE-së, nuk ka mundur të realizohet brenda afatit fillestar të caktuar nga ZRRE-ja, për shkak të pengesave të cilat u paraqitën më lartë, duke përfshirë vështirësitë administrative dhe financiare të cilat kanë pasur rol të rëndësishëm porsa i përket realizimit të këtij projekti.
- Poashtu është dashur të pritët edhe ndryshimi i Pëlqimit Energjetik dhe Pëlqimi i fundit i reviduar nga KEDS, të cilin pas një kohe të gjatë e kanë pranuar me 18.05.2018. Gjithashtu është dashur të vazhdojmë edhe Lejen e Ndërtimit të cilën me datë 13.03.2018 kemi pranuar Vendimin me nr. 06 nr. 35/2018 (për vazhdimin e validitetit të Lejes Ndërtimore Sh. 06 Nr. 156/2016 dt. 10.08.2016), të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Komuna e Kamenicës.
- Andaj, bazuar në të gjitha ato që u paraqitën më lartë, shoqëria "SOLAR GREEN ENERGY"SH.P.K., ka kërkuar nga Bordi i ZRRE-së, që duke u mbështetur në dispozitat ligjore të nenit 16 par. 4 të Rregullës për procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, t'iu lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit FINAL V_838_2016 të datës 03 tetor 2016, për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga panelet solare/fotovoltaike edhe për një (1) vit, në mënyrë që të arrijnë të përfundojnë këtë projekt të rëndësishëm për



prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtitshme, dhe duke pasur parasysh dinamikën ekzistuese të punimeve që janë duke u realizuar tash nga kompania zbatuese, ky projekt do të implementohet tërësisht deri në fund të vitit 2018, por, njëkohësisht këtë shtyrje po e kërkojmë edhe për sigurinë e financimit nga banka e cila ka kërkuar zgjatjen e afatit edhe për një vit, në mënyrë që të liferohet edhe pjesa e kredisë për finalizimin e këtij projekti.

- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së shoqërisë “SOLAR GREEN ENERGY” SH.P.K., dhe dëshmive të bashkangjitura për shtyrje të afatit të vlefshmërisë të Autorizimit Final, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, në vendin e quajtur Xharimes ZK Novosell, me kapacitet të instaluar prej 3 MW, Komuna e Kamenicës, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se arsyeshmëria e kërkesës së aplikuesit është e bazuar, dhe duke u mbështetur në shkresat e lëndës, ku janë prezantuar fakte se brenda kësaj periudhe do të finalizohet projekti, ka vendosur që të lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final V_838_2016 i datës 03 tetor 2016, edhe për një afat shtesë ligjor, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi.
- II. Vendimi për Lëshimin e Autorizim Final V_838_2016 i datës 3 tetor 2016, do të vlen deri me datë **3 tetor 2019**, sipas dispozitivin nën pikën I., të këtij vendimi, në rast se nuk arrin të përfundoj ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese nga Uji, apo nuk vepron në pajtim me legjislacionin në fuqi, vendimi do të shfuqizohet.
- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Kamenicës,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së,dhe
- Arkivit të ZRRE-së.